



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Nr. 376 Prot.

Tiranë, më 27.01.2020

Lënda: “Njoftim mbi shtyerjen e veprimtarisë së procesit të verifikimit të Kontabilistëve të Miratuar”

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi “Bajram Curi”, mbrapa shkollës së Baletit, kati 2, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar,

Në zbatim të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, rregullores nr. 9, datë 27.02.2019, “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të kontabilistit të miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, Bordi i Mbikëqyrjes Publike në kuadër të reformës për forcimin dhe përmirësimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes së funksionimit të profesionistëve, kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë, si dhe organizatave të tyre profesionale me Vendimin e tij nr. 61, datë 26.12.2019 ka miratuar shtyerjen e veprimtarisë së Komisionit Ad-Hoc për verifikimin e Kontabilistëve deri më datë 30 Qershor 2020.

Për rrjedhojë afati i dorëzimit të dokumentacionit të subjekteve KM pranë Komisionit Ad-Hoc do të shtyhet deri me datë 30 Prill 2020. Për më tepër, afati për plotësimin e detyrimit të subjekteve KM për kryerjen e edukimit të vijueshëm profesional do të shtyhet deri me datë 30 Qershor 2020.

Për sa më sipër, lutemi të kryeni njoftimin e anëtarësisë tuaj në lidhje me ndryshimet në afatet, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR EKZEKUTIV

Aldo SPAHIU

